

Rregullimi i Procedurës dhe të dhënat disiplinore në Komunën e Vushtrrisë 2022-2023

Hyrje

Ndërtimi i një administrate lokale transparente dhe llogaridhënëse dhe me integritet është njëri nga synimet kryesore të Republikës së Kosovës. Megjithatë, në veçanti integriteti në shërbimin publik vazhdon të mbetet sfidë. Në veçanti në nivel komunal evidentohet nevoja për të promovuar hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit në shërbimin publik si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës.¹

Për ta arritur këtë qëllim përpos llogaridhënies para publikut, institucionet e Kosovës kanë ndërtuar mekanizma konkret të cilët kërkojnë llogari nga nëpunësit në procedurat administrative, duke mos përjashtuar edhe procedurën penale në rastet kur shkeljet sanksionohen me Kodin Penal.

Mekanizma të llogaridhënies për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës janë vlerësimi i performancës dhe në veçanti procedurat disiplinore.

Për këtë qëllim komunat kanë hartuar kodet e etikës ndërsa Qeveria e Kosovës ka miratuar rregulloren përkatëse për disiplinë.

BIRN në hulumtime paraprake kishte konstatuar se një numër i vogël i zyrtarëve të nivelit lokal përfshihen në procedura disiplinore për shkeljet e kryera gjatë punës.

Me qëllim të dokumentimit të kuptimit të arsyeve pse në vend ka numër të vogël të procedurave disiplinore, BIRN ka realizuar pesë hulumtime në komuna të ndryshme të vendit për të matur nivelin e edukimit për disiplinën dhe nivelin e zbatimit të procedurave dhe kodit të etikës në komunat përkatëse.

Në Komunën e Vushtrrisë BIRN ka gjetur se:

- Komuna ka hartuar Kodin e Etikës i cili nuk i zbaton standardet europiane për procedurat disiplinore për të emëruarit politikë;
- Kodi i Etikës ka kufizime të cilat bien ndesh me të drejtat dhe liritë politike;
- Komuna nuk ka ndërmarrë një fushatë për të edukuar zyrtarët e saj për zbatimin e kodit dhe procedurave disiplinore;
- Në fusha të caktuara zyrtarët e komunës nuk i njohin mirë normat e etikës;

¹ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2023, i qasshëm në linkun - https://integrimievropian.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf

- Problemet e theksuara në kuptimin e fushave të parandalimit të konfliktit të interesit dhe procedurave disiplinore;
- Komuna e Vushtrrisë ka një numër simbolik të procedurave disiplinore të hapura ndaj zyrtarëve të saj;
- Të gjitha procedurat disiplinore janë hapur sipas detyrës zyrtare nga mbikëqyrësit ndërsa nuk ka procedura të cilat janë iniciuar nga zyrtarët e tjerë të komunës, zyrtarët e institucioneve të tjera qytetarët apo organizatat e shoqërisë civile;
- Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të promovuar hyrjen në fuqi të Kodit të Etikës dhe për të inkurajuar qytetarët që të raportojnë shkeljet e mundshme disiplinore të zyrtarëve;
- Procesi i disiplinimit zhvillohet nga zyrtarë të komisionit të cilët nuk u janë nënshtruar testeve për matjen e njohurive mbi disiplinën dhe nuk janë trajnuar për të zhvilluar procedura disiplinore;
- Komuna nuk ka të përcaktuar rregulla specifike për kompensimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore brenda komunës.

Metodologjia

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluar në mes muajve shkurt dhe mars, duke përdorur tri forma të grumbullimit të të dhënave.

BIRN në metodologji ka përcaktuar qëllimet e hulumtimit duke i grupuar ato në tri shtylla:

- Niveli i Edukimit mbi etikën dhe disiplinën në komunë
- Analizimin e bazës ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës
- Zbatimin në praktikë të kodeve të etikës dhe rregullave disiplinore

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë grumbulluar të shtrira në tri faza hulumtuese.

Në fazën e parë BIRN ka realizuar një takim informues me zyrtarë të Komunës së Vushtrrisë dhe gjatë takimit janë marrë të dhëna paraprake për përgatitjen e fazës së dytë. Në fazën e parë, BIRN po ashtu ka analizuar bazën ligjore të rregullimit të etikës dhe disiplinës në komunë në raport me kërkesat që përcaktohen në standardet europiane të qeverisjes së mirë lokale.

Të dhënat nga faza e parë janë përdorur për të zhvilluar gjetjet e këtij raporti por edhe për të hartuar një pyetësor me 17 pyetje hulumtuese për zyrtarët komunalë të cilët janë përfshirë në studim.

Faza e dytë ka korresponduar me një matje në terren për të testuar njohuritë e zyrtarëve komunalë mbi kodin e etikës dhe procedurën disiplinore.

10 zyrtarë komunalë të përzgjedhur nga komuna i janë nënshtruar një procesi të testimit me 17 pyetje të përgatitura nga BIRN, e të cilat përmbajnë informacione për kodin e etikës dhe kodin e procedurës disiplinore.

Testimi është realizuar në prani të hulumtuesve të BIRN dhe zyrtarëve të komunës.

Zyrtarët e përfshirë në këtë studim ishin nga drejtoritë e Prokurimit, Financave, Administratës, Arsimit, Shëndetësisë. Identiteti i tyre është mbajtur i fshehur për qëllime të mbrojtjes së privatësisë.

Në fazën e tretë të hulumtimit, BIRN ka pranuar nga komuna përgjigjet në 12 pyetje hulumtuese në të cilat janë mbledhur të dhëna për:

- Numrin e ankesave disiplinore;
- Numrin e ankesave ex-officio disiplinore;
- Numrin e vërejtjeve nga menaxherët e linjës;
- Numrin e vërejtjeve dhe sanksioneve disiplinore nga komisionet përkatëse;
- Numrin e ankesave të hedhura poshtë nga institucionet, si Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil;
- Përdorimin e teknologjisë informative për të kontrolluar disiplinën (sistemi i burimeve njerëzore SIMBN). Sa përdoret ky sistem? A kanë njohuri për përdorim të këtij sistemi;

Për këtë fushë ka realizuar edhe një intervistë të thellë me drejtorin e Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila korrespondon me mbi 30 pyetje hulumtuese. Të dhënat nga statistikat dhe intervista e thellë do të paraqiten në vazhdimësi gjatë këtij raporti

Gjetjet kryesore

Komuna ka hartuar Kodin e Etikës i cili nuk i zbaton standardet europiane për procedurat disiplinore për të emëruarit politikë

Komuna e Vushtrrisë ka të themeluara dy komisione disiplinore, Komisionin Disiplinor për Nëpunësit Civil dhe Komisionin Disiplinor. Të dyja këto komisione përbëhen nga tre anëtarë dhe në përbërje kanë së paku nga një jurist siç e parasheh edhe Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197² Po ashtu, Komuna e Vushtrrisë ka në zbatim Kodin e Etikës të miratuar në korrik të vitit 2020³

Një nga risitë që është synuar të sjellë ky Kod ishte rregullimi i çështjeve disiplinore për të zgjedhur dhe të emëruarit politikë.

Bislim Dushi – Udhëheqës i Njesisë së Burimeve, i intervistuar nga BIRN deklaroi se ky Kod i Etikës për dallim nga Kodi paraprak parasheh edhe përgjegjësinë e zyrtarëve politikë të Komunës së Vushtrrisë në drejtim të disiplinës.⁴

Kodi i Etikës së Komunës së Vushtrrisë në nenin tre, tek pjesa e përkufizimeve parasheh përkufizimet për zyrtarët ndaj të cilëve vlen Kodi i Etikës. Pika 1.1 e këtij neni parasheh përkufizimin për zyrtarin politik komunal.

1.1 Zyrtari politik komunal – është çdo zyrtar i zgjedhur për kryetar të komunës, anëtarë të kuvendit komunal, drejtor i drejtorive dhe stafi mbështetës i tyre.

² Ligji për Zyrtarët Publikë i qasshëm në linkun - <https://qzk.rks-qov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>

³ Kodi i Etikës së Komunës së Vushtrrisë i qasshëm në linkun - <https://kk.rks-qov.net/vushtrri/ep-content/uploads/sites/33/2021/07/KODI-I-ETIKES-2020.pdf>

⁴ Intervista e realizuar nga BIRN me z. Bislim Dushi, Udhëheqës i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, datë 12 mars 2024.

Po tek kjo pjesë e përkufizimeve sqarohet se termi 'zyrtar komunal', i përdorur në këtë Kod përfshin edhe zyrtarët politikë edhe nëpunësit civil komunalë.

Gjithë përmbajtja e Kodit të Etikës duke përfshirë nënin pesë të Kodit, nuk bën ndonjë ndarje në mes të zyrtarëve politikë komunalë dhe nëpunësve civil komunalë por i adresohet të dy kategorive dhe i bën përgjegjës për sjelljet e përcaktuara me këtë Kod.

Kreu IV i Kodit i titulluar 'Zbatimi dhe Masat Disiplinore' në nënin 33 'Zbatimi' parasheh se Kodi i Etikës zbatohet nga të gjithë nëpunësit komunalë.

Megjithatë, neni 35 "Masat Disiplinore" dhe neni 36 "*Procedura për trajtimin e shkeljeve*", nuk kanë arritur të adresojnë në tërësi kërkesat dhe standardet europiane të qeverisjes së mirë lokale. Neni 35 përcakton se "*të gjithë zyrtarët komunalë që shkelin dispozitat të përcaktuara në këtë Kod, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të zbatueshëm*".

Megjithatë, Rregullorja për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë 11/2020 dhe Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civilë 01/2024 që ka shfuqizuar rregulloren paraprake, e që derivon nga Ligji për Zyrtarët Publikë 08/L-197, përjashton të zgjedhurit, të emëruarit politikë dhe zyrtarët e kabinetit.

Kjo nënkupton se edhe pse Kodi i Komunës së Vushtrrisë ka paraparë edhe zyrtarët politikë komunalë t'i nënshtrohen përcaktimeve të këtij Kodi, nuk është përcaktuar ndonjë procedurë specifike e rregulluar dhe efikase për të zyrtarët politikë komunalë.

Po ashtu edhe neni 36 i Kodit të Etikës së Komunës së Vushtrrisë që përcakton procedurat për trajtimin e shkeljeve nuk ka asnjë përcaktim të vetëm lidhur me zyrtarët politikë dhe procedurën që ata mund t'i nënshtrohen në rast se sjellja e tyre bie ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës.

Mungesën e procedurës për të emëruarit politikë e konfirmon edhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore për Komunën e Vushtrrisë, Bislim Dushi.

"Nuk ka komision por nuk do të thotë se nuk zbatohet Kodi i Etikës ndaj tyre. Nëse kryetari i Komunës e konsideron se ka një shkelje nga një drejtor i një drejtorie apo ndonjë anëtar i kabinetit atëherë Kryetarit i jepet e drejta që të kërkojë respektimin e masave apo të ndërmarrë masa nga një komision ose komision ad-hoc", tha Dushi.⁵

Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal⁶ e Këshillit të Europës ka paraparë parimet e qeverisjes së mirë në nivel lokal. Parimi i gjashtë i kësaj Strategjie parasheh sjelljen etike që pritet edhe nga zyrtarët e zgjedhur dhe politikë.

⁵ Intervista e realizuar nga BIRN me z. Bislim Dushi, Udhëheqës i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, datë 12 mars 2024.

⁶ Strategjia për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal e qasshme në linkun - [1680746f16 \(coe.int\)](https://www.coe.int)

Kodi i Etikës së Komunës së Vushtrrisë nuk ka arritur të përcaktojë procedura të rregulluara dhe efikase për të zyrtarët politikë.

Kodi i etikës ka kufizime të cilat bien ndesh të drejtat politike

Kodi i Etikës së Komunës së Vushtrrisë në nenin 5 “*Respektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve*”, ka paraparë kushtëzime të cilat nuk kanë asnjë mbështetje ligjore dhe për më tepër kufizojnë të drejtat dhe liritë politike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet relevante për zgjedhjet dhe qeverisjen lokale, nuk kanë përcaktuar ndonjë kufizim për ndërrimin e subjektit politik i takojnë.

“Duke respektuar vullnetin e votuesve, zyrtari politik komunal duhet të shmangë ndryshimin e partisë që i përket gjatë mandatit të tij në detyrë”, përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 5 të Kodit të Etikës.

Ky përcaktim i Kodit të Etikës i dedikohet ekskluzivisht zyrtarëve komunalë politikë dhe urdhëron “duhet”, të shmangët ndryshimi i partisë gjatë mandatit të tij në detyrë.

Përderisa sistemi elektoral me lista të hapura dhe me një zonë zgjedhore nuk e ndalon ndryshimin e përfaqësimit politik të anëtarëve të kuvendit dhe gjithashtu mandati i anëtarit të kuvendit i takon atij, është shkelje ligjore që nëpërmes Kodit t’i ndalohen lëvizjet brenda grupeve të përfaqësuar në kuvend.

Ligji për vetëqeverisje lokale nuk i njeh partitë politike (grupet politike) si entitet të veçantë politik por e trajton mandatin e anëtarit të kuvendit si trupë e veçantë përfaqësuese.

Përderisa Komunitat kanë të drejtën e plotë që të përcaktojnë sjelljet që duhet të shmangen dhe sjelljet që priten nga zyrtarët komunalë, në asnjë rrethanë nuk mund të vendosin kufizime që cenojnë lirinë e përcaktimit politik të zyrtarëve politikë.

Mungesa e aktiviteteve njoftuese rreth Kodit të Etikës për qytetarët

Komuna e Vushtrrisë përveç se e ka publikuar Kodin e Etikës në ueb-faqen e Komunës së Vushtrrisë, nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër për të njoftuar qytetarët e Vushtrrisë lidhur me Kodin e Etikës si dokument që përcakton veprimet e pahijshme që mund të kryejnë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, procedurat që duhet ndjekur, afatet e parashkrimit të shkeljeve dhe çështjet tjera që ndërlidhen me procedurat disiplinore.

Sipas z. Dushi, Udhëheqës i Burimeve Njerëzore, Komuna e Vushtrrisë ka të vendosur “Kutinë e Ankesave” në objekt të Komunës mirëpo rezulton se të paktën në vitin 2022 dhe 2023 nuk kanë pranuar asnjë ankesë të vetme nga qytetarët që përbën informacion për shkelje disiplinore.

Viti	Numri i ankesave të paraqitura nga qytetarët ndaj zyrtarëve të Komunës	Numri i ankesave të parashtruara nga zyrtarët ndaj zyrtarëve tjerë komunal
2022	0	0
2023	0	0

Të dhënat e paraqitura në tabelë më lartë pasqyrojnë sesi qytetarët në Komunën e Vushtrrisë nuk kanë paraqitur asnjë rast të vetëm për inicim të procedurës disiplinore në dy vitet e fundit.

Mungesa e aktivitetet njoftuese rreth Kodit të Etikës për zyrtarët

Numri total i të punësuarve në Administratën e Komunës së Vushtrrisë është 162 zyrtarë ndërsa numri i stafit politik është gjithsej 19 zyrtarë.

Numri total i të punësuarve në Komunën e Vushtrrisë	Numri i nëpunësve civil	Numri i nëpunësve të shërbimit publik	Numri i performuesve të artit	Numri i stafit mbështetës
162	135	5	6	16

Numri i stafit politik në Komunën e Vushtrrisë	19
--	----

Kodi i Etikës është njëri nga dokumentet me të cilin njoftohen të gjithë zyrtarët e Komunës të cilët po ashtu nënshkruajnë edhe një deklaratë zotimi mirëpo rezulton se Komuna e Vushtrrisë nuk ka ndërmarr asnjë veprim të vetëm shtesë për të njoftuar zyrtarët komunal lidhur me rregullimin ligjor e nënligjor të Ligjit për Zyrtarët Publikë (pjesën e disiplinës), Rregulloren për Disiplinën e Nëpunësve Civilë 01/2024⁷ apo Rregulloren për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë (QRK).

Viti	Numri i ankesave të paraqitura nga qytetarët ndaj zyrtarëve të Komunës	Numri i ankesave të parashtruara nga zyrtarët ndaj zyrtarëve tjerë komunal
2022	0	0
2023	0	0

Përderisa nuk kemi pasur asnjë rast të ankesave nga qytetarët apo nga një zyrtar ndaj zyrtarit tjetër (të rangut të njëjtë apo më të lartë), numri i ankesave të parashtruara nga mbikëqyrësi direkt ndaj nëpunësve komunalë dallon esencialisht.

Viti	Numri i ankesave të parashtruara nga mbikëqyrësi direkt për nëpunës civil	Numri i ankesave të parashtruara nga mbikëqyrësi direkt për nëpunës të shërbimit publik	Numri i ankesave të parashtruara nga mbikëqyrësi direkt për staf mbështetës
2022	2	2	1
2023	1	1	0

⁷ Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civil 01/2024 e qasshme në linkun - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30883>

Të dhënat e paraqitura në këtë tabelë pasqyrojnë se rastet e vetme disiplinore të iniciuara në Komunën e Vushtrrisë ndaj nëpunësve civilë dhe atyre të shërbimit publik janë rastet e parashtruara nga mbikëqyrësi direkt ndërsa mungojnë në tërësi rastet e nisura nga qytetarët apo nëpunësit e tjerë.

Mënyra e zgjidhjes së rasteve

Mënyra e zgjidhjes së rasteve disiplinore	Nëpunës të shërbimit publik	Nëpunës të shërbimit civil
2022	2 raste ndërprerje e marrëdhënies së punës	0
2023	Suspendim me 50% të pagës (aktakuzë)	0

Mënyra e zgjidhjes së rasteve evidenton se nga gjithsej 2 raste të iniciuara nga mbikëqyrësi direkt gjatë vitit 2022 për nëpunës të shërbimit publik, në të dyja rastet është ndërprerë marrëdhënia e punës – sanksioni më i rëndë disiplinor.

Të dhënat nga pyetësorët

Me qëllim të pasqyrimin të njohjes së disa prej koncepteve bazike lidhur me Kodin e Etikës së Komunës dhe Rregullores për Disiplinë për Nëpunësit Civil - BIRN ka zhvilluar pyetësorin për zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë të cilët janë përzgjedhur në mënyrë rastësore ndërsa të dhënat që mund të identifikojnë pjesëmarrësit në pyetësor nuk janë kërkuar.

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës së shërbimit civil:

1 zyrtar	1 deri 5 vite
9 zyrtarë	Më shumë se 10 vite

Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve lidhur me Kodin e Etikës

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Ndaj kujt zbatohet Kodi i Etikës së Komunës?	3	7	0
2. Sa është shuma e dhuratave që mund të pranojnë zyrtarët në punën e tyre?	7	2	1
3. Kujt duhet t'i raportoni për pranimin e dhuratave	8	0	2
4. Çka nënkupton situata e konfliktit të interesit?	5	0	5
5. Konfidencialiteti pas përfundimit të marrëdhënies së punës	6	0	4

6. Sa anëtarë ka komisioni disiplinor?	8	0	2
7. A lejohet pjesëmarrja në vendimmarrje për të disiplinuar, ngritur në detyrë, disiplinuar apo shkarkuar personin e afërm	7	0	3
8. Përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Etikës dhe njoftimit është Njësia e Burimeve Njerëzore?	9	0	1

Nga të dhënat e pyetësorëve që ndërlidhen me Kodin Etikës rezultojnë se nga 10 zyrtarët e intervistuar, 5 prej tyre nuk e kanë të qartë konceptin e konfliktit të interesit që përshkruhet në Kodin e Etikës.

Po ashtu, rezultojnë se nga 10 zyrtarët që i janë nënshtruar pyetësorit, 3 prej tyre janë përgjigjur se mund të kenë vendimmarrje në procese për të ngritur në detyrë, disiplinuar apo shkarkuar personin e afërm të tyre.

Më tej, 4 nga 10 zyrtarët që kanë plotësuar pyetësorin kanë rezultuar të pasaktë në pyetjen lidhur me mbrojtjen e të dhënave pas përfundimit të marrëdhënies së punës.

Trajnimet e zyrtarëve komunalë lidhur me Kodin e Etikës apo Rregulloren për Disiplinë

Numri i trajnimeve të zhvilluara rreth Kodit të Etikës dhe Procedurës Disiplinore	
6 zyrtarë	0
2 zyrtarë	1
1 zyrtar	2
1 zyrtar	2

Të dhënat e gjeneruara nga pyetësori evidentojnë se nga 10 zyrtarët që i janë nënshtruar pyetësorit, 6 prej tyre nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim rreth Kodit të Etikës apo procedurave disiplinore përkundër që po nga pyetësori rezultojnë se 9 nga 10 zyrtarët e intervistuar kanë mbi 10 vjet përvojë punë si zyrtar komunal.

Pyetjet dhe përgjigjet e zyrtarëve komunalë lidhur me Rregullat dhe procedurën disiplinore

Pyetja	Saktë	Pjesërisht Saktë	Pasaktë
1. Kush është kompetent për shqiptimin e masave disiplinore?	3	7	0
2. Me rastin e shqiptimit të masës disiplinore merren parasysh edhe përpjekjet për zvogëlimin e dëmit?	7	0	3
3. Sa është afati për ankesë ndaj vendimit disiplinor?	3	0	7
4. Shkelja e përsëritur e rregullave të Kodit të Etikës konsiderohet si shkelje e lehtë?	9	0	1
5. Kush e shqipton masën “ndalimi i ngritjes në detyrë”?	8	0	2

6. Afati i parashkrimit të shkeljeve të lehta është 3 vjet kurse i shkeljeve të rënda 6 vjet?	5	0	5
7. Kush e bënë kualifikimin e shkeljeve në të rënda apo të lehta?	1	0	9
8. Kush e themelon Komisionin Disiplinor?	10	0	0
9. Kush është shkalla e dytë ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor?	8	0	2

Nga të dhënat e gjeneruara nga pyetëtori rezulton se 3 nga 10 zyrtarët nuk janë të informuar se nëse bëjnë përpjekje për të minimizuar apo zvogëluar dëmin.

Po ashtu, rezulton se gjysma e zyrtarëve nuk janë përgjigjur saktë lidhur me afatet e parashkrimit të shkeljeve disiplinore. Teksa dy prej zyrtarëve nuk e dinë se ku mund të ankohen ndaj vendimeve disiplinore.

Vetëm një nga zyrtarët komunalë është përgjigjur saktë në pyetjen se kush e bënë kualifikimin e shkeljeve në të lehta apo të rënda duke shpërfaqur kështu një mosnjohje të thellë të procedurës disiplinore.

Mungesa e trajnimeve për anëtarët e Komisionit disiplinor dhe mungesa e kompensimit shtesë për anëtarët e saj;

Anëtarët e komisioneve disiplinore të Komunës së Vushtrrisë nuk i janë nënshtruar asnjë trajnimi lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës së Komunës, procedurave disiplinore të përcaktuara me rregulloret dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë.

Për më tepër, përveç se nuk ka pasur ndonjë trajnim apo vlerësim paraprak për anëtarët e komisioneve disiplinore para se ata të përzgjidheshin si anëtarë të komisioneve disiplinore, nuk ka pasur as deri më datë 12 mars 2024 kur është realizuar intervista me z. Bislim Dushi.

Po ashtu, zyrtarët që shërbejnë si anëtarë të komisioneve disiplinore nuk kompensohen për punën e tyre si anëtarë të komisioneve e kjo edhe sipas z. Bislim Dushi.

Rekomandimet:

- Komuna e Vushtrrisë të ndryshojë Kodin e Etikës dhe të përcaktojë procedura për trajtimin e rasteve disiplinore ndaj të zgjedhurve dhe të emëruarve politikë dhe stafit të tyre mbështetës;
- Komuna e Vushtrrisë të ndryshojë Kodin e Etikës, saktësisht të fshijë paragrafin 2 të nenit 5 të Kodit të Etikës me të cilën dispozitë synohet të detyrohen zyrtarët politikë të mos ndërrojnë partinë e tyre;
- Komuna e Vushtrrisë të ndërtojë fushata vetëdijesuese me qëllim të njoftimit të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë rreth Kodit të Etikës dhe procedurave disiplinore të cilave mund t'ju nënshtrohen zyrtarët komunalë me qëllim të rritjes së numrit të ankesave të qytetarëve;

- Komuna e Vushtrisë të zhvillojë programe trajnimi të vazhdueshme për zyrtarët komunalë lidhur me Kodin e Etikës dhe procedurat disiplinore;
- Komuna e Vushtrisë të zhvillojë trajnime me zyrtarët komunalë me qëllim të përditësimit të njohurive lidhur me vendimmarrjen në situata të konfliktit të interesit dhe konfliktit të interesit në përgjithësi;
- Komuna të përcaktojë një Plan Veprimi me anë të të cilit të parashoh aktivitete në zbatim të Kodit;
- Komuna duhet të organizojë takime të rregullta periodike për të vlerësuar zbatimin e Kodit;
- Komuna e Vushtrisë të zhvillojë programe trajnimi dhe vlerësimi me zyrtarët komunalë rreth procedurave disiplinore;
- Komuna e Vushtrisë në bashkëpunim me IKAP duhet të zhvillojë programe për trajnimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore;
- Komuna e Vushtrisë të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve komunalë në drejtim të instrumenteve për parandalimin e korrupsionit;
- Komuna e Vushtrisë të ndërtojë modalitete për mbikëqyrjen e cilësisë së punës, në veçanti politikën ndëshkimore disiplinore të komisioneve disiplinore;

Kjo analizë është përgatitur nga BIRN-i përmes mbështetjes nga Aktiviteti i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për Integritetin e Komunave të Kosovës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë artikull nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.